



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar

Numër 4

T E T O R 2 0 2 0

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve për Inflacionin

Numër 4

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Analizave Ekonomike
dhe i Stabilitetit Financiar

33 Garibaldi, Prishtinë 10000

Tel: ++383 38 222 055

Fax: ++383 38 243 763

Faqja e internetit

www.bqk-kos.org

Adresa elektronike

economic.analysis@bqk-kos.org

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

Përmbajtja

Anketa e Kreditimit Bankar	7
Përmbledhja e rezultateve	7
Kutia 1. Metodologjia	10
Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe kërkesën për kredi	11
Kreditë ndaj ndërmarrjeve	11
Standardet kreditore	11
Kushtet dhe rregullat.....	12
Kërkesa për kredi.....	12
Kreditë ndaj ekonomive familjare	14
Standardet kreditore	14
Kushtet dhe rregullat.....	14
Kërkesa për kredi.....	15
Financimi	16
Rezultatet e pyetjeve të fokusuara: Ndikimet e Covid-19 në sektorin bankar	17
Pritjet për Inflacionin	19
Metodologjia	19
Përmbledhja e rezultateve	19

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

Anketa e Kreditimit Bankar

Hyrje¹

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve analitike për një vlerësim sa më të mirë të dinamikave të kreditimit në Kosovë dhe pritjeve për zhvillimet në nivelin e çmimeve, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka dizajnuar dhe realizuar një anketë me bankat komerciale që operojnë në tregun bankar në Kosovë. Raporti që do të analizoj rezultatet e këtij anketimi do të publikohet në frekuencë tremujore në webfaqen e BQK-së, me qëllim që të ofrojë një pasqyrë më të gjerë rreth perceptimit të rrezikut të bankave dhe gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, si dhe, sjelljes së ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve kundrejt dinamikave në kreditim si pasojë. Ky raport evidenton sjelljen kreditore për periudhën e tremujorit të dytë të vitit 2020, dhe pritjet e bankave për dinamikën në kreditim për tremujorin e tretë të vitit 2020.

Përveç pyetjeve standarde, në këtë anketë u shtuan edhe disa pyetje mbi ndikimin potencial të masave parandaluese të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës kundrejt përhapjes së virusit Covid-19 mbi ofertën kreditore dhe ndikimin e tyre në sektorë të caktuar të ekonomisë, rrezikun kryesor të perceptuar nga bankat, si dhe ndikim që kishin skemat lehtësuese të ndërmarra për menaxhimin e krizës pandemike.

Përmbledhja e rezultateve

Oferta kreditore është shtrënguar si dhe kërkesa për kredi ka shënuar rënie të theksuar gjatë tremujorit të dytë të vitit, sipas rezultateve të anketës së bankave komerciale. Këto zhvillime i atribuohen rritjes së pasigurive me shpalljen e gjendjes pandemike dhe masave parandaluese për përhapjen e saj, të ndërmarra si në vend ashtu edhe në ekonominë e jashtme. Me gjithë pasiguritë e larta që vazhdojnë të shoqërojnë gjendjen pandemike, lehtësimi i masave kufizuese diktoi pritjet e bankave për ofertë kreditore të pandryshuar dhe rritje të kërkesës kreditore në tremujorin e tretë të vitit 2020.

Dinamika e ngadalësimit të ritmit të rritjes së stokut të kredive për ndërmarrjet gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, si dhe përgjysmimi i kredive të reja gjatë tremujorit të dytë krahas periudhës së njëjtë të vitit të kaluar, u ndikua negativisht si nga ana e ofertës kreditore, ashtu edhe nga kërkesa për kredi. Ndërsa, pritjet e bankave për tremujorin vijues rezultojnë të jenë më optimiste. Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan se kanë shtrënguar konsiderueshëm standardet e aplikuar gjatë vlerësimit të aplikacioneve të ndërmarrjeve për kredi gjatë tremujorit të dytë 2020, e që është në linjë me pritjet e deklaruara në anketën e kaluar. Standardet kreditore për të dy kategoritë e ndërmarrjeve u shtrënguan konsiderueshëm dhe në masë të njëjtë. Ky rezultat doli nga deklaratimet e shtatë bankave nga gjithsej nëntë banka pjesëmarrëse në anketë. Qasja më konservatore e bankave kundrejt kreditimit të ndërmarrjeve iu atribuua kryesisht masave të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19, faktor që ka ndikuar në rritjen e rrezikut të perceptuar nga bankat (ndërprerjet e tërësishme në disa aktivitete biznesore, gjegjësisht tkurrja e aktivitetit të pjesës më të madhe të bizneseve të regjistruara në vend). Ndër tjerash, pasigurinë e rritur me pandeminë Covid-19 e ndikuan negativisht edhe faktorë të tjerë si përkeqësimi i perspektivës së tregut vendor dhe global, rënia e cilësisë së portfolios kreditore, si dhe ulja e tolerancës së bankave ndaj rrezikut.

Për tremujorin e tretë të vitit 2020, pritjet e bankave konsistojnë kryesisht në standarde kreditore të pandryshuara. Përkundër pasigurive rreth dinamikave që do të ndjekë në muajt në vijim gjendja

¹ Për informata më të detajuara rreth qëllimit dhe historikut të anketës së kreditimit bankar në BQK, shikoni publikimin "Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit" Nr. 1

pandemike, bankat kanë bazuar pritjet për standarde kreditore të pandryshuara në vendimet për lehtësimin e masave kufizuese dhe rrjedhimisht pritjeve për rimëkëmbjen e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjeve në vend. Sidoqoftë, standardet kreditore për kreditë afatgjata pritet të jenë të shtrënguara deri në një masë edhe në tremujorin vijues.

Kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet u shtrënguan deri në një masë në këtë periudhë. Kushte dhe rregulla të shtrënguara u aplikuan për të dy kategoritë e ndërmarrjeve, kryesisht përmes zvogëlimit të madhësisë së kredive dhe shkurtimit të maturitetit, ndërsa për NVM-të gjithashtu kishte rritje të normës së interesit. Faktorët që ndikuan në shtrëngimin e kushteve të kreditimit ishin masat e ndërmarrja për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19, që për pasojë u reflektuan edhe në perspektivë jo të favorshme të tregut vendor dhe atij ndërkombëtar, rënie të tolerancës së sektorit ndaj rrezikut, si dhe rritjen e rrezikut nga kolaterali i kërkuar. Ndërkohë, për tremujorin e tretë të vitit 2020, bankat pritet të aplikojnë ofertë kreditore kryesisht të pandryshueshme për ndërmarrjet, si pasojë e lehtësimit të masave kufizuese ndaj përhapjes së Covid-19.

Gjatë tremujorit të dytë, kërkesa e ndërmarrjeve për kredi bankare rezultoi të jetë zvogëluar dukshëm, megjithatë në nivel më të ulët se sa pritjet e deklaruara për TM2 2020 nga bankat në anketën e kaluar. Indeksi negativ që rezultoi pas indeksimit të përgjigjeve të bankave lidhur me kërkesën për kredi, i atribuohet në një masë më të lartë NVM-ve krahas ndërmarrjeve të mëdha. Në kuadër të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet, bankat deklaruan se kryesisht kishte rënie të kërkesës për financimin e investimeve fikse dhe ristrukturimit të borxhit deri në një masë. Në TM3 2020, pritet ngritje e aktivitetit për një pjesë të madhe të ndërmarrjeve si pasojë e lehtësimit të masave të ndërmarrja për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19. Këto pritje u pasqyruan në parashikimet e bankave për rritje të kërkesës për kredi deri në një masë kryesisht nga NVM-të, përderisa kërkesë kryesisht e pandryshuar pritet nga ndërmarrjet e mëdha. Rritja e kërkesës nga NVM-të pritet t'i atribuohet rritjes së kërkesës për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues, e që pasqyron nevojat akute të likuiditetit të ndërmarrjeve. Po ashtu, bankat presin rritje deri në një masë të kërkesës për ristrukturim të borxhit duke u bazuar në 'Udhëzuesin për ristrukturim të kredive për shkak të Covid-19', i miratuar nga BQK në qershor 2020, e që mundëson lehtësime për tejkalimin e vështirësive financiare si pasojë e krizës pandemike.

Dinamikat e aktivitetit kreditues për ekonomitë familjare gjatë periudhës raportuese u ndikuan negativisht si nga oferta kreditore ashtu edhe nga kërkesa për kredi, ku kreditë e reja u përgjysmuan në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare, sipas anketës, rezultojnë të jenë shtrënguar duke marr parasysh që masat kundër parandalimit të përhapjes së Covid-19 ishin më të koncentruara gjatë këtij tremujori. Me tërheqjen e masave kufizuese gjatë tremujorit vijues, pritjet e bankave japin indikacione për lehtësim të standardeve kreditore për segmentin e ekonomive familjare, në veçanti për kreditë konsumuese. Kjo do të nxiste rritjen e konsumit, si katalizator për rimëkëmbjen e aktivitetit ekonomik në vend.

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për segmentin e ekonomive familjare u shtrënguan deri në një masë, kryesisht përmes zvogëlimit të shumës së kredisë së aprovuar, afateve më të shkurtra të maturimit, si dhe në një masë më të vogël përmes kërkesave më të larta për kolateral. Ngjashëm me sektorin e ndërmarrjeve, faktorët kyç që ndikuan në shtrëngimin e kushteve dhe rregullave të kreditimit për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 ishin masat e ndërmarrja për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19, të cilat nxitën përkeqësimin e perspektivës për tregun vendor dhe atë ndërkombëtar, toleranca e ulët ndaj rrezikut, si dhe në një masë më të vogël, perspektiva jo e mirë në tregun e patundshmërive. Për tremujorin e tretë të vitit 2020, bankat deklaruan se presin që kushtet dhe rregullat për kredi për ekonomitë familjare të mbesin kryesisht të pandryshuara, me përjashtim të uljes së normës së interesit për kreditë për blerjen e shtëpive dhe

rritjen e shumës së kredive të aprovuara për kreditë konsumuese. Këto pritje u bazuan në një tolerancë lehtësisht më të lartë ndaj rrezikut dhe presion të rritur të konkurrencës edhe pse me indeks pozitiv marginal.

Meqë masat për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19 përfshinë një pjesë të madhe të tremujorit të dytë, kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare rezultoi të jetë ndikuar konsiderueshëm. Në këtë tremujor, bankat raportuan rënie të konsiderueshme të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, një rënie më e theksuar tek kreditë konsumuese kundrejt kërkesës për kreditë për blerje të shtëpive. Bankat raportuan se rënia e kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare i është atribuar kryesisht rënies së besueshmërisë së klientëve për aftësinë e ripagimit të kredive dhe perspektivës jo të kënaqshme të tregut të patundshmërive. Në tremujorin e tretë të vitit 2020, bankat presin rritje të kërkesës për kredi deri në një masë për kreditë konsumuese, përderisa kërkesa për kredi për blerjen e shtëpive pritet të mbetet kryesisht e pandryshuar. Sidoqoftë, rezultatet e anketës sugjerojnë se bankat ia atribuon këto pritje rritjes së kërkesës për ristrukturim të borxhit dhe jo rritjes së kërkesës për financim të konsumit që do të kishte dhënë kontribut pozitiv në rritjen e aktivitetit ekonomik në vend.

Pasiguritë e larta rreth prospekteve ekonomike, si pasojë e krizës shëndetësore dhe mbylljes së aktiviteteve biznesore rezultuan në rritje të rrezikut kreditor. Përkundër masave lehtësuese të ndërmarra nga BQK për pezullimin e pagesave të kësteve të kredive, bankat deklaruan rritje të raportit të kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive në tremujorin e dytë të 2020. Sipas pritjeve të deklaruara nga bankat, ky indikator pritet të përkeqësohet tutje në tremujorin vijues përkundër tërheqjes së masave kufizuese dhe programeve mbështetëse për rimëkëmbjen e ekonomisë në vend.

Rezultatet e anketës tregojnë që financimi i bankave gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 u ndikua pozitivisht vetëm nga depozitat e ekonomive familjare, përderisa të gjitha burimet tjera të financimit nuk patën ndryshime të rëndësishme. Kjo sugjeron për nevojën e ndërmarrjeve për të shfrytëzuar paranë e gatshme për mbulimin e mungesave të likuiditetit, në vend se të depozitohet në sektorin bankar. Gjatë tremujorit të ardhshëm, bankat presin rritje më të lartë të qasjes në financim. Financimi përmes depozitave të ndërmarrjeve pritet të rritet në nivel të përafërt me depozitat e ekonomive familjare. Njëkohësisht, dy banka me rëndësi sistematike presin gjithashtu mbështetje në financim të aktivitetit bankar nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Kutia 1. Metodologjia

Pyetësi i Anketës së Kreditimit Bankar

Pyetësi i AKB është i bazuar në format e standardizuara të pyetësorëve të përdorur nga Bankat Qendrore në eurozonë dhe më gjerë. Megjithatë, pyetësi i BQK për AKB është modifikuar dhe përshtatur që në mënyrën më të mirë dhe gjithëpërfshirëse të paraqet zhvillimet e kreditimit në sektorin bankar në Kosovë.

Pyetësi i AKB përbëhet nga 19 pyetje, të cilat mbulojnë ndryshimet në ofertën kreditore, ndryshimet në kërkesën për kredi, faktorët që kontribuojnë në këto ndryshime si dhe qasjes në financim të sektorit bankar. Pyetjet mbi kreditimin bankar fokusohen në dy kategori kryesore: (i) kreditë ndaj ndërmarrjeve, dhe (ii) kreditë ndaj ekonomive familjare. Për më tepër, kreditë ndaj ndërmarrjeve nën-kategorizohen në kreditë ndaj NVM-ve dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve të mëdha, përderisa kreditë ndaj ekonomive familjare nën-kategorizohen në kreditë për blerjen e shtëpive dhe kreditë konsumuese. Për të gjitha kategoritë e lartpërmendura, ndryshimet në ofertën kreditore përcaktohen nga standardet kreditore të aplikuara gjatë aprovimit të kredive, kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e reja, norma e aprovimit të kredive, si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimet e tyre. Ndërsa, ndryshimet në kërkesën për kredi përcaktohen nga kërkesa për kredi (numri i aplikacioneve për kredi), cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi, si dhe faktorët që e ndikojnë kërkesën për kredi. Pyetjet e anketës kryesisht janë formuluar për ndryshimet gjatë tre muajve paraprak dhe ndryshimeve të pritura gjatë tre muajve të ardhshëm. Gjithashtu, pyetjet mbulojnë kreditë edhe në aspekt të maturimit të tyre dhe valutës në të cilën lëshohen.

Përveç pyetjeve standarde, pyetësi i AKB mund të përmbajë edhe pyetje shtesë mbi çështje specifike me interes për shpjegimin e zhvillimeve në sektorin bankar. Përderisa pyetjet standarde mbulojnë një periudhë tre-mujore, pyetjet shtesë mund t'i referohen ndryshimeve gjatë një periudhe kohe më të gjatë. Në anketim marrin pjesë nëntë nga dhjetë bankat që operojnë në Kosovë. Rrjedhimisht, bankat pjesëmarrëse përfaqësojnë tregun e përgjithshëm bankar dhe sigurojnë një përfaqësim të duhur statistikor, duke marrë parasysh se përfaqësojnë rreth 98 përqind të aseteve të gjithësej sektorit bankar dhe 99.8 përqind të gjithësej kreditimit në sektorin bankar.

Pjesëmarrësve të anketës u kërkohet të tregojnë në mënyrë cilësore forcën e çdo shtrëngimi ose lehtësimi apo forcën e çdo ulje ose rritje, duke raportuar ndryshimet përmes pesë shkallëve si: (i) shtrënguar / ulur në mënyrë të konsiderueshme, (ii) shtrënguar / ulur në një masë, (iii) e pandryshuar, (iv) lehtësuar / rritur në një masë ose (v) lehtësuar / rritur në mënyrë të konsiderueshme.

Gjenerimi i rezultateve të anketës së kreditimit bankar

Kuantifikimi i përgjigjeve të marra nga bankat individuale dhe agregimi i tyre për të paraqitur ndryshimet në nivel sektori arrihet përmes gjenerimit të një indeksi. Ky indeks gjenerohet për çdo kategori e nën-kategori të secilës pyetje, duke dhënë në këtë mënyrë një njësi kuantifikuese për përgjigjet e marra në nivel të sektorit.

Fillimisht, përgjigjeve u përcaktohet një vlerë në bazë të forcës së ndryshimeve, konkretisht përgjigjeve ku bankat kanë deklaruar shtrëngim/ulje të konsiderueshme u përcaktohet vlera - 1, vlerë dyfish më e madhe se sa ajo e përcaktuar për përgjigjet kur bankat deklarojnë shtrëngim / ulje deri në një masë (vlerë prej - 0.5). Ngjashëm, përgjigjet kur kemi lehtësim / rritje të konsiderueshme kanë vlerë 1, përderisa ato me lehtësim/rritje deri në një masë u përcaktohet vlera 0.5. Rezultatet po ashtu janë të peshuara në bazë të peshës që secila prej bankave ka në gjithësej kreditimin e sektorit bankar. Përfundimisht, pesha e secilës bankë sipas pjesëmarrjes në tregun e kredive shumëzohet me vlerën e përcaktuar në bazë të intensitetit të përgjigjes së dhënë, duke fituar indeksin në fjalë.

Më tutje, agregimi i indeksit në nivel sektori bëhet përmes shumës së indekseve të fituara për secilën bankë. Vlerat e indeksit janë në mes të -1 dhe 1, ku vlerat pozitive të indeksit paraqesin lehtësim, rritje apo kontribut pozitiv dhe në kontrast vlerat negative paraqesin shtrëngim, rënie apo kontribut negativ.

Pyetësi, si dhe seria kohore e rezultateve të AKB, janë në dispozicion në faqen e internetit të BQK-së, nën vegzën e Anketës së Kreditimit Bankar.


Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe kërkesën për kredi

Kreditë ndaj ndërmarrjeve

Standardet kreditore

Standardet kreditore (udhëzimet e brendshme të bankave apo kriteret për aprovimin e kredive) të aplikuara për ndërmarrjet në përgjithësi u shtrënguan konsiderueshëm gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020, të përkthyer në indeks negativ, prej 0.64 (indeks negativ prej 0.15 në TM1 2020). Në anketën e kaluar (TM1 2020), bankat kishin deklaruar pritje të përafërta për standarde kreditore konsiderueshëm të shtrënguara në TM2 2020 (grafiku 1).

Grafik 1. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuon



Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, bankat deklaruan indeks negativ prej 0.64 për ndryshimet në standardet kreditore si për ndërmarrjet e mëdha ashtu edhe për NVM-të. Ky rezultat bazohet në deklaratat e shtatë bankave nga gjithsej nëntë banka pjesëmarrëse në anketë.

Rol kryesor në shtrëngimin e standardeve të aplikuara nga bankat në TM2 2020, rezulton të kenë luajtur masat e ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19, ku pjesa më e madhe e bankave raportuan kontribut negativ edhe pse këto masa gradualisht filluan të lehtësohen prej gjysmës së tremujorit në fjalë. Masave të implementuara, pas indeksimit të përgjigjeve të bankave, iu atribua një indeks negativ prej 0.61. Për më tepër, këto masa përshkallëzuan edhe kontributin e faktorëve tjerë në shtrëngim të standardeve kreditore. Rrjedhimisht, bankat perceptuan rrezik të rritur si pasojë e pasigurive në perspektivën e tregut të brendshëm në përgjithësi (faktori me indeksin më të lartë negativ prej 0.72), si dhe në perspektivën e tregut global. Po ashtu, bankat deklaruan rënie të tolerancës së sektorit ndaj rrezikut, rritje të rrezikut kreditor dhe rritje të rrezikut nga faktorët ndërkombëtar (si pasojë e pasigurive të shtuara në tregjet ndërkombëtare). Faktori i vetëm me ndikim pozitiv në standardet kreditore ishte financimi nga banka amë deklaruar nga një bankë. Në linjë me ofertën e shtrënguar, norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet shënoi rënie të theksuar në këtë periudhë, mirëpo shkalla e rënies ishte më e ulët se ajo në shtrëngimin e standardeve kreditore.

Bankat pritet t'i mos i shtrëngojnë më tutje standardet kreditore dhe t'i mbajnë kryesisht të pandryshuara gjatë TM3 2020, duke u bazuar në pritjet për rimëkëmbje të ekonomisë në vend dhe jashtë vendit, me lehtësimin apo tërheqjen e masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19 gjatë tremujorit në fjalë. Bankat gjithashtu presin që mbështetja e FKGGK-së për NVM-të do të ndikojë në lehtësim të standardeve deri në një masë. Njëra prej bankave me rëndësi sistemike po ashtu deklaroi se pret kontribut pozitiv në standardet kreditore nga rënia e rrezikut në kolateralin e kërkuar dhe përmirësimi i gjendjes në sferën ndërkombëtare.


Konkretisht, bankat me pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej kreditimin e sektorit deklaruan se presin standardet kreditore të pandryshuara, përderisa bankat tjera presin shtrëngim apo lehtësim deri në një masë, rrjedhimisht pas indeksimit të përgjigjeve rezultoi një indeks pozitiv mirëpo i ulët prej 0.06. Standarde kreditore të njëjta pritet të aplikohen si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha. Njëkohësisht, bankat pritet të vazhdojnë me ofertë të shtrënguar deri në një masë për kreditë afatgjata (indeks negativ prej 0.11).

Në linjë me pritjet për standardet kreditore, norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet pritet po ashtu të mbetet kryesisht e pandryshuar me indekse të ulëta, saktësisht për NVM-të me një indeks pozitiv prej 0.04, për ndërmarrjet e mëdha me një indeks negativ prej 0.05.

Kushtet dhe rregullat

Në TM2 2020, në përgjithësi, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet (kushtet dhe rregullat përkatëse të një kontrate të caktuar për kredi) u shtrënguan deri në një masë (grafiku 2). Konkretisht, për NVM-të shtrëngim deri në një masë kishte në normat e interesit (indeks negativ prej 0.18), madhësinë e kredive të aprovuara (indeks negativ prej 0.30) dhe në maturitetin e kredive të reja (indeks negativ prej 0.16). Kushtet dhe rregullat për kreditë e ndërmarrjeve të mëdha po ashtu u shtrënguan mirëpo në një nivel shumë më të ulët, përmes shtrëngimit deri në një masë të madhësisë së kredive (indeks negativ prej 0.17), dhe maturitetit më të ulët (indeks negativ prej 0.08).

Grafik 2. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ndërmarrjet



Faktorët që ndikuan në shtrëngimin e kushteve dhe rregullave ishin kryesisht masat e ndërmarra për parandalimin e përhapjes së Covid-19, që për pasojë u reflektuan në perspektivë jo të favorshme të tregut vendor dhe atij ndërkombëtar, rënie të tolerancës së sektorit ndaj rrezikut, si dhe rritjen e rrezikut nga kolaterali i kërkuar.

Si pasojë e lehtësimit të masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së Covid-19, bankat për TM3 2020 nuk presin vazhdim të shtrëngimit të kushteve dhe rregullave. Bankat pritet të aplikojnë ofertë kreditore kryesisht të pandryshuar për ndërmarrjet, duke u bazuar në kushtet dhe rregullat e ofruara. Në këtë kontekst, bankat deklaruan që presin kufizim të madhësisë së kredive për të dy kategoritë e ndërmarrjeve mirëpo në një nivel të ulët. Faktori me kontribut pozitiv në kushtet dhe rregullat për kreditë e reja dhe me indeks mjaft të lartë prej 0.35 gjatë TM3 2020, pritet të jetë mbështetja e FKGK-së për NVM-të. Përderisa, rritja e rrezikut kreditor në vend dhe jashtë tij u cilësuan si faktorë që pritet të kontribuojnë negativisht.

Kërkesa për kredi


Gjatë tremujorit të dytë, kërkesa për kredi nga ana e ndërmarrjeve shënoi rënie të dukshme, e që rezultoi të jetë në një nivel më të ulët se sa pritjet e bankave në anketën e kaluar (TM1 2020) (grafiku

3). Specifikisht, kërkesa për kredi nga NVM-të u tkurr në nivel më të lartë me një indeks negativ prej 0.41, dhe kërkesa nga ndërmarrjet e mëdha me një indeks negativ prej 0.25. Ngrirja e veprimtarive ekonomike të shumë sektorëve të ndërmarrjeve, e rrjedhimisht, edhe pasiguria për aftësinë e tyre për kthimin e kredive dhe plotësimin e kriterëve për marrjet e kredive ndikuan në rënien e kërkesave për kredi nga ndërmarrjet.

Sipas anketës, rënia e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet në masë më të madhe u ndikua nga rënia e theksuar e kërkesës për financimin e investimeve fikse (indeks negativ prej 0.52) dhe deri në një masë nga zvogëlimi i kërkesës për ristrukturim të borxheve (indeks negativ prej 0.15). Njëkohësisht, cilësia e aplikacioneve të pranuar u përkeqësua, veçanërisht për NVM-të.

Sipas anketës, raporti i kredive jo-performuese të ndërmarrjeve vazhdoi të karakterizohet me indeks pozitiv prej 0.10 (nivel i ngjashëm me anketën paraprake me indeks pozitiv prej 0.11), që nënkupton rritje deri në një masë të kredive jo-performuese të ndërmarrjeve.

Grafik 3. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuan



Përgjatë tremujorit vijues pritet ngritje e aktivitetit për një pjesë të madhe të ndërmarrjeve si pasojë e lehtësimit të masave të ndërmarrja për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19. Këto pritje u pasqyruan në parashikimet e bankave për ndryshimet në kërkesën për kredi gjatë TM3 2020. Rrjedhimisht, kërkesa pritet të rritet deri në një masë kryesisht nga NVM-të (indeks pozitiv prej 0.24), përderisa kërkesë kryesisht e pandryshuar pritet nga ndërmarrjet e mëdha (indeks pozitiv prej 0.06). Rritja e kërkesës për kredi pritet të ndikohet nga rritja e kërkesës së ndërmarrjeve për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues. Po ashtu, bankat presin rritje deri në një masë të kërkesës për ristrukturim të borxhit duke u bazuar në 'Udhëzuesin për ristrukturim të kredive për shkak të Covid-19'², i miratuar nga BQK në qershor 2020, i cili mundëson lehtësime për tejkalimin e vështirësive financiare si pasojë e krizës pandemike. Pjesëmarrja e ndërmarrjeve në aplikimet për pezullimin e pagesës së kësteve të kredive deri në qershor 2020 ishte 74.2 përqind e gjithsej aplikimeve, apo 46.9 përqind e gjithsej stokut të kredive. Kjo përqindje e madhe e kërkesave pasqyron shkallën e lartë të ndërmarrjeve të prekura nga masat për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19. Rrjedhimisht, bankat presin që raporti i kredive jo-performuese të përkeqësohet edhe më tutje në TM3 2020 me një indeks pozitiv prej 0.39.

Përkundër pritjeve për rinisje të aktiviteteve për një pjesë të madhe të sektorëve ekonomik, bankat nuk presin përmirësime në cilësinë e aplikacioneve për kredi nga ndërmarrjet. Andaj, pritet për TM3 janë të ngjashme, me një indeks marginal negativ prej 0.02 për NVM-të dhe indeks negativ prej 0.11 për ndërmarrjet e mëdha.


Kreditë ndaj ekonomive familjare

Standardet kreditore

Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 përgjithësisht u shtrënguan në krahasim me tremujorin paraprak me një indeks negativ prej 0.37 për kreditë për blerjen e shtëpive dhe indeks negativ prej 0.28 për kreditë konsumuese. Gjithashtu, pritjet për tremujorin e dytë të deklaruara nga bankat në anketën e kaluar sugjeronin për shtrëngim të përafërt të standardeve kreditore të aplikuara (grafiku 4). Njëkohësisht, bankat deklaruan të kenë ulur normën e aprovimit të kredive për ekonomitë familjare në një masë më të madhe për kreditë konsumuese (indeks negativ prej 0.44) se sa për kredi për blerjen e shtëpive (indeks negativ prej 0.30).

Masat e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për pezullimin apo zvogëlimin e aktivitetit në sektor të caktuar ekonomik me qëllim të parandalimit të përhapjes së pandemisë ndikuan pjesën më të madhe të tremujorit të dytë, gjë që kontribuoi negativisht në ndryshim të standardeve kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare. Këto masa u përkthyen në rritje të rrezikut të perceptuar të tregut vendor dhe ndërkombëtar në përgjithësi, të aftësisë paguese të klientëve, uljen e tolerancës ndaj rrezikut dhe rënien potenciale të cilësisë së portfolios kreditore.

Grafik 4. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan



Burimi: BQK.

* Vlera e pritur


Në tremujorin e tretë 2020, kryesisht duke u bazuar në lehtësimin e masave për parandalimin e përhapjes së Covid-19 dhe masave mbështetëse të ndërmarra nga institucionet e vendit, bankat presin standarde kreditore të lehtësuara për ekonomitë familjare me një indeks pozitiv prej 0.26. Standardet kreditore pritet të lehtësohen në një nivel më të lartë për kreditë konsumuese se sa për kreditë për blerjen e shtëpive, me indeks pozitiv prej 0.26 dhe 0.11, respektivisht. Përkundër që nuk është reflektuar në pritjet e përgjithshme për standardet kreditore, bankat kanë deklaruar se përkeqësimi i cilësisë së portfolios kreditore, masat e ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19 dhe ulja deri në një masë e tolerancës së bankave ndaj rrezikut pritet të kontribuojnë negativisht në standardet kreditore gjatë TM3 2020. Njëkohësisht, bankat presin rritje të dukshme të nivelit të aprovimit të kredive, në një masë më të madhe për kreditë konsumuese se sa për kreditë për blerjen e shtëpive, indeks pozitiv prej 0.38 dhe 0.11 respektivisht.

Kushtet dhe rregullat

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare përgjithësisht u shtrënguan në tremujorin e dytë të vitit 2020, edhe pse në nivel të ulët. Shtrëngimi i kushteve dhe rregullave ishte i ngjashëm si për kreditë konsumuese, ashtu edhe për ato për blerje të shtëpive. Kryesisht, kushtet dhe rregullat u shtrënguan përmes uljes së shumës së aprovuar (indeks negativ prej 0.18 për kreditë për blerjen e shtëpive dhe 0.24 për kreditë konsumuese) dhe rritjes së kërkesave për kolateral (indeks i

ulët negativ prej 0.10 për të dy llojet e kredive). Përveç këtyre kushteve dhe rregullave për kreditë për blerjen e shtëpive bankat gjithashtu ulën periudhën e maturitetit me një indeks negativ prej 0.12. Ulja e ngarkesave tjera përveç normës së interesit përbën lehtësimin e vetëm në kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e reja gjatë këtij tremujori me indeks pozitiv prej 0.13 për të dy llojet e kredive për ekonomitë familjare (grafiku 5).

Grafik 5. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ekonomitë familjare



Faktorët që kontribuan në shtrëngimin e kushteve dhe rregullave të aplikuara janë kryesisht masat e ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19, e që si pasojë u reflektua edhe në perspektivë jo të favorshme të tregut vendor dhe atij ndërkombëtar, tolerancë të ulët ndaj rrezikut si dhe perspektivë jo të mirë në tregun e patundshmërive.

Për tremujorin e tretë të vitit 2020, bankat deklaruan se presin që kushtet dhe rregullat për kredi për ekonomitë familjare të mbesin kryesisht të pandryshuara, me përjashtim të uljes deri në një masë të normës së interesit për kreditë për blerjen e shtëpive dhe rritjes deri në një masë të shumës së kredive të aprovuara për kreditë konsumuese. Këto pritje u bazuan në një tolerancë lehtësisht më të lartë ndaj rrezikut dhe presion të rritur të konkurrencës, megjithëse ky i fundit me indeks pozitiv marginal.


Kërkesa për kredi

Pasiguria e ekonomive familjare në sigurimin e të ardhurave, e si pasojë edhe në aftësinë paguese, u reflektua në rënien e konsiderueshme të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare në tremujorin e dytë të vitit 2020. Bankat raportuan për rënie të kërkesës për kredi për të dy kategoritë e kredive të ekonomive familjare, e sidomos për kreditë konsumuese. Shtatë nga gjithsej nëntë banka pjesëmarrëse në anketë deklaruan rënie të kërkesës për kredi konsumuese, ku pas indeksimit të përgjigjeve rezultoi indeks negativ prej 0.74. Ndërsa, kërkesa për kredi për blerjen e shtëpive kishte një indeks negativ prej 0.57. Nëse krahasojmë rezultatet aktuale të kërkesës për kredi me pritjet e bankave të deklaruara në anketën e kaluar për të njëjtën periudhë, niveli i rënies së kërkesës është pothuajse i njëjtë, mirëpo dallimi qëndron në atë që pritjet ishin për rënie më të lartë për kreditë për blerjen e shtëpive se sa për kreditë konsumuese (grafiku 6).

Kjo rënie iu atribua në masë më të madhe rënies së besueshmërisë së klientëve për aftësinë e ripagimit të kredive me indeks negativ prej 0.56, dhe në një masë më të ulët perspektivës jo të kënaqshme të tregut të patundshmërive me indeks negativ prej 0.46. Bankat po ashtu deklaruan që në një nivel më të ulët, në rënie të kërkesës ndikoi gjithashtu rënia e financimit të konsumit dhe ristrukturimit të borxhit. Rënia e kërkesave për ristrukturim të borxhit reflekton vendimet në fuqi për pezullimin e përkohshëm për pagesën e kësteve të kredive, për të mundësuar menaxhim më efikas të goditjes potenciale të sektorit bankar nga kriza ekonomike. Pjesëmarrja e ekonomive familjare në aplikimet për pezullimin e pagesës së kësteve të kredive deri në qershor 2020 ishte 25.8 përqind e

gjithsej aplikimeve, apo 16.3 përqind e gjithsej stokut të kredive. Cilësia e aplikacioneve të pranuar kishte rënie të theksuar për të dy kategoritë e kredive për ekonomitë familjare. Bankat deklaruan përkeqësim të mëtutjeshëm të cilësisë së portfolios kreditorë bazuar në përgjigjet për rritjen e raportit të kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive për ekonomitë familjare me indeks pozitiv prej 0.34 kundrejt indeksit negativ prej 0.17 sa deklaruan bankat në anketën e kaluar (TM1 2020).

Grafik 6. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan



Në tremujorin e tretë të vitit 2020, bankat presin rritje të kërkesës për kredi deri në një masë për kreditë konsumuese, përderisa kërkesa për kredi për blerjen e shtëpive pritet të mbetet kryesisht e pandryshuar. Bankat deklaruan se presin rritje të kërkesës për kredi konsumuese me indeks pozitiv prej 0.31, raportuar nga gjashtë banka pjesëmarrëse në anketim. Rezultatet e anketës sugjerojnë se bankat ia atribuon këto pritje rritjes së kërkesës për ristrukturim të borxhit në tremujorit e tretë të 2020. Rritja e kërkesës për ristrukturim të borxhit, nënkupton rritjen e ekonomive familjare të prekura nga masat për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19 dhe vështirësitë e tyre në përmbushjen e obligimeve kreditorë. Konform këtij qëndrimi, bankat presin rritje të theksuar të rrezikut kreditor në tremujorin e tretë të vitit 2020, bazuar në pritjet për rritje të raportit të kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive të ekonomive familjare me një indeks pozitiv prej 0.45

Njëkohësisht, bankat deklaruan se presin përmirësim në masë të vogël të cilësisë së aplikacioneve për kredi nga ekonomitë familjare, veçanërisht për kreditë konsumuese me një indeks pozitiv prej 0.10.

Financimi


Bankat nuk raportuan ndryshime të mëdha të qasjes në financim gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020. Duke marrë parasysh modelin tradicional të sektorit bankar në Kosovë ku financimi dominohet nga depozitat e ekonomive familjare dhe të ndërmarrjeve, rreziku për zvogëlimin potencial të të hyrave të realizuara nga këto dy segmente nwse nuk intervenohet me masa lehtësuese mund të reflektohet në nivelin e depozitave nw sektorin bankar..

Rezultatet e anketës tregojnë që financimi i bankave gjatë tremujorit të dytë të 2020 u ndikua pozitivisht vetëm nga depozitat e ekonomive familjare me një indeks prej 0.30, përderisa të gjitha burimet tjera të financimit nuk patën ndryshime të rëndësishme (grafiku 7). Një nga bankat e anketuara deklaroi rritje të financimit deri në një masë nga banka amë, përderisa një bankë tjetër me peshë më të lartë në kreditimin e sektorit deklaroi se kishte rënie të financimit nga banka amë, gjë që ndikoi në një indeks afër zeros për këtë komponentë. Sipas maturitetit, indeksi ishte më i ulët për depozitat afatshkurtra se sa për ato afatgjata në këtë tremujor, specifikisht indeks pozitiv prej 0.11 dhe 0.17, respektivisht.

Për tremujorin e ardhshëm, bankat presin rritje më të lartë të qasjes në financim. Financimi përmes depozitave të ekonomive familjare pritet të rritet në një nivel të përafërt me depozitat e ndërmarrjeve,

indeks pozitiv prej 0.33 dhe 0.27, respektivisht. Në tremujorin e tretë, dy banka me rëndësi sistematike presin mbështetje në financim të aktivitetit bankar nga institucionet financiare ndërkombëtare. Përderisa, dy banka deklaruan se presin mbështetje në financimin nga bankat amë, mirëpo në një nivel të ulët. Sipas maturitetit, në tremujorin e ardhshëm pritet të vazhdojë rritja më e lartë e financimit afatgjatë krahas atij afatshkurtër, saktësisht indeks pozitiv prej 0.21 dhe 0.10, respektivisht (grafiku 7).

Grafik 7. Ndryshimet në financimin e sektorit bankar



Rezultatet e pyetjeve të fokusuar: Ndikimet e Covid-19 në sektorin bankar

Pyetësi i anketës për tremujorin e dytë 2020 është plotësuar me katër pyetje shtesë, me qëllim të vlerësimit të ndikimit të krizës së shkaktuar nga pandemia Covid-19 në ofertën e përgjithshme kreditore, si dhe kundrejt sektorëve të caktuar të ekonomisë. Gjithashtu, pyetjet adresojnë edhe perceptimin e bankave për rreziqet që janë nxitur nga kriza e shkaktuar nga pandemia Covid-19, si dhe efektivitetin e masave të ndërmarra nga institucionet e vendit në adresimin e rreziqeve të rritura në këtë periudhë.

Pjesa më e madhe e bankave deklaruan se gjatë tremujorit të dytë, fokusi kryesor ishte në shqyrtimin dhe implementimin e pezullimit të përkohshëm të pagesës së kësteve të kredive aktuale. Megjithatë, masat që bankat ndërmorën ndikuan në shtrëngimin e ofertës kreditore e veçanërisht për ndërmarrjet. Masa shtesë u vendosën në shqyrtimin e aprovimit të kredive të reja, të cilat ishin në numër të vogël sidomos gjatë gjysmës së parë të tremujorit në fjalë. Masat shtesë përfshijnë vëzhgimin më të detajuar të performancës së klientëve duke i kategorizuar ata në shkallë sipas rrezikut që bartin si klientë, kërkesa për dokumente plotësuese, si dhe kriteret e reja varësisht prej kërkesave të klientëve bazuar në maturitetin dhe madhësinë e financimit të kërkuar. Përderisa shumica e bankave në përgjithësi shtrënguan ofertën kreditore, një nga bankat theksoi se ofruan kredi me kushte më të mira në mënyrë që ndërmarrjet të menaxhojnë më mirë vështirësitë financiare gjatë kësaj periudhe. Për pjesën e mbetur të vitit, bankat shprehen optimiste në rimëkëmbjen e aktivitetit ekonomik në vend si rezultat i tërheqjes së masave kufizuese. Andaj, bankat presin të vazhdojnë me kreditimin e sektorëve ekonomik por me kujdes më të shtuar dhe vëzhgim më të afërt të performancës financiare të klientëve. Gjatë tremujorit të dytë, bankat veçse shtuan analiza dhe klasifikime të brendshme të sektorëve ekonomik. Sektorët me vëzhgim të shtuar e në raste edhe me zvogëlim e pezullim të financimit kryesisht janë sektori i hotelarisë, gastronomisë, transportit dhe ndërtimitarisë. Duke përcjell zhvillimin e pandemisë, bankat pritet të aplikojnë masat e lartpërmendura edhe në pjesën e mbetur të vitit për sektorët në fjalë.

Sa i përket rreziqeve në rritje për sektorin bankar gjatë kësaj periudhe, bankat deklaruan që rreziku kreditor mbetet rreziku kyç i sektorit gjatë këtij viti, përderisa aplikimi i masave të aplikuara nga BQK për menaxhimin e cilësisë së portfolios kreditore të sektorit përmes shtyrjes së pagesave të

kësteve pa ndikuar klasifikimin kreditor të klientëve dhe pa provizionime shtesë për klientët e prekur nga masat për parandalimin e përhapjes së Covid-19, arriti të zbusë ndikimin e tij gjatë tremujorit të dytë. Disa banka deklaruan rritje të rrezikut të likuiditetit në fillim të pandemisë Covid-19, megjithatë pjesa tjetër e sektorit nuk e perceptuan si rrezik në rritje atë të likuiditetit dhe solvencës gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2020. Rreziqet e shtuara për sektorin bankar sipas përgjigjeve nga bankat u nxitën nga rënia e aktivitetit ekonomik, rënia e mundshme e fondeve në formë të remitencave si pasojë e karakterit global të pandemisë si dhe kufizimeve në lëvizje, që pritet të reflektohet në rënie të konsumit dhe investimeve.

Në pyetjen shtesë mbi ndikimin e FKGK dhe Pakos Fiskale Emergjente në ofertën dhe kërkesën për kredi, bankat deklaruan për mbështetje të pjesshme, si pasojë e zgjatjes së zbatimit të pakos si pasojë e shtyrjes së procesit të miratimit të plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020. Si rezultat i dinamikave politike në vend, aprovimi i marrëveshjeve me institucionet financiare ndërkombëtare për ndihmë financiare për rimëkëmbjen e ekonomisë nuk arriti të përmbillet, si dhe implementimi i Pakos Fiskale Emergjente ishte i mangët, rrjedhimisht ndikimi i tyre në ofertën e kërkesën për kredi gjatë tremujorit të dytë ishte tejet i kufizuar. Megjithatë, një numër i madh i bankave deklaruan për mbështetje të mirë nga FKGK edhe pse marrëveshjet për rritjen e këtij fondi nuk u aprovuan nga Qeveria gjatë tremujorit në fjalë. Në pjesën e mbetur të vitit, bankat presin mbështetje më të madhe nga këto iniciativa, si dhe aprovimin e Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike që subjektet ekonomike të mund të përballojnë sa më lehtë pasojat e pandemisë Covid-19.

Pritjet për Inflacionin

Me qëllim të avancimit të kapaciteteve analitike dhe duke u bazuar në praktikat më të mira rajonale dhe më gjerë, BQK ka vazhduar me anketimin e institucioneve financiare në vend, duke u mbështetur në hipotezën se institucionet financiare bartin praktikat më të mira nga bankat amë dhe kanë ekspertizën e duhur për të projektuar dinamikat e inflacionit. Si rezultat, nga tremujori i tretë i vitit 2019, AKB është pasuruar edhe me pyetje shtesë, që adresojnë pritjet e bankave komerciale për zhvillimet në çmime në vend, duke ndihmuar kështu dhe plotësuar analizat tona në aspektin e analizimit, modelimit dhe parashikimit.

Në pyetësorin e fundit të realizuar në korrik 2020, përveç deklarimit të bankave lidhur me vlerësimet që kanë për nivelin e inflacionit në tremujorin e dytë të vitit 2020, pyetësori adreson edhe pritjet e bankave për tremujorin e tretë dhe për vitin 2020 në përgjithësi. Anketa shërben gjithashtu edhe si një mjet për identifikimin e faktorëve specifik që potencialisht mund të ndikojnë pritjet e bankave për nivelin e caktuar të inflacionit.

Metodologjia

Pritjet e inflacionit luajnë të paktën dy role të rëndësishme. Së pari, ofrojnë një statistikë përmbledhëse kuantifikuese për shkallën e inflacionit në të ardhmen, dhe së dyti, mund të përdoren për të vlerësuar besueshmërinë e objektivitetit të inflacionit të vendosur nga bankat qendrore.

Rëndësia e pritjeve të inflacionit është më e lartë për vendet të cilat e kanë adoptuar strategjinë e shënjestrimit të inflacionit. Për këto vende, pritjet e inflacionit, ndër të tjera, shërbejnë edhe si një tregues i besueshmërisë së publikut ndaj bankës qendrore. Nëse besohet se banka qendrore do të reagojë për të arritur objektivin, atëherë edhe pritjet e agjentëve ekonomik lidhur me shkallën e inflacionit do të ishin më pranë objektivit. Pritjet e inflacionit janë të rëndësishme edhe për bankat të cilat nuk posedojnë politikë monetare, duke qenë se shërbejnë si input i rëndësishëm në përcaktimin e çmimeve dhe pagave, si dhe në procesin e modelimit dhe parashikimit. Për më tepër, pritjet e inflacionit ndikojnë kërkesën agregate, që më pas ndikon ecurinë e inflacionit.

Për dallim nga inflacioni aktual i cili matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pritjet lidhur me inflacionin vlerësohen me metoda të tërthorta. Ndër më të përdorurat është anketimi i agjentëve ekonomikë: konsumatorëve, bizneseve, bankave komerciale, etj. Banka Qendrore e Kosovës, për herë të parë ka filluar me vlerësimin e pritjeve për inflacionin në tremujorin e tretë të vitit 2019, fillimisht me bankat komerciale dhe në të ardhmen pritet të zgjerohet edhe me agjentë të tjerë ekonomik.

Vlerësimet që merren nga bankat komerciale janë të formës sasiore të shoqëruara edhe me shpërndarje të probabilitetit. Pritjet për inflacionin vlerësohen për horizonte të ndryshme kohore, fillimisht pritjet për tërë vitin aktual, shoqëruar edhe me vlerësimet për tremujorin paraprak si dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm. Mbledhja e informacionit përmes anketave pasohet nga procesi i sistemimit, përpunimit dhe agregimit për të gjetur mesataren e pritjeve të inflacionit nga bankat komerciale. Analiza e pritjeve të inflacionit pritet të jetë pjesë e raporteve të rregullta të BQK-së.

Përmbledhja e rezultateve

Bazuar në anketën e realizuar në korrik të vitit 2020, shumica e bankave presin që inflacioni do të jetë më i ulët në vitin 2020 krahasuar me vitin e kaluar, por edhe për tremujorin e dytë të vitit 2020 kanë vlerësuar nivel më të ulët të inflacionit krahasuar me tremujorin paraprak. Bankat presin që inflacioni do të jetë 1.0 përqind në vitin 2020 nga 2.7 përqind sa ishte inflacioni në vitin 2019 (tabela 1). Anketa e realizuar në korrik përfshinë edhe efektet potenciale që presin bankat pas përballjes me gjendjen e re të paprecedent të shkaktuar nga pandemia Covid-19.

Tabela 1. Pritja e inflacionit nga bankat, ndryshimi vjetor në përqindje

Bankat	2020	TM2 2020	TM3 2020
1	0.7%	1.0%	0.3%
2	0.9%	0.1%	0.5%
3	0.5%	0.1%	0.4%
4	-0.6%	0.1%	-0.4%
5	0.9%	0.2%	0.7%
6	1.4%	0.8%	1.1%
7	2.7%	2.5%	2.6%
8	1.3%	0.5%	1.0%
9	1.4%	0.5%	0.5%
Mesatarja	1.0%	0.6%	0.7%


Burimi: Bankat komercial dhe kalkulimet e BQK-së.

Të dhënat e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për vitin 2019, sugjerojnë se inflacioni ishte rreth 2.7 përqind, që është nivel i përafërt me pritjet e bankave. Në anketën e realizuar me bankat komerciale për tremujorin e kaluar, vlerësimet e bankave kanë qenë se niveli i inflacionit ishte rreth 0.6 përqind në TM2 2020. Të dhënat aktuale për këtë tremujor sugjerojnë se niveli i inflacionit ishte 0.2 përqind që është nivel më i ulët krahasuar me pritjet e bankave. Sa i përket tremujorit të tretë të vitit 2020, bankat presin që niveli i inflacionit do të jetë në masën prej 0.7 përqind. Shumica e bankave (gjashtë sosh) presin që inflacioni do të sillet ndërmjet intervalit 0 dhe 1 përqind, ndërsa dy bankat tjera presin që inflacioni do të jetë më i lartë se 1 përqind dhe një bankë tjetër pret që të kemi deflacion në tremujorin e tretë të vitit 2020. Siç ilustron figura 8, shpërndarjet e raportuara të probabilitetit tregojnë një pasiguri relativisht të ulët në lidhje me rezultatin e ardhshëm të inflacionit, pasi shpërndarja e probabilitetit të bankave është e përqendruar në inflacionin e pritur. Në komentet e tyre cilësore, bankat kanë cituar disa faktorë të mundshëm për nivelin e inflacionit:

- ✓ COVID-19. Disa prej bankave kanë thënë se për shkak të shkëputjes së zinxhirit të furnizimit, çmimet mund të rriten ndërsa shumica kanë deklaruar se masat për parandalimin e përhapjes së virusit korona pritet të ndikojnë në rënien e aktivitetit ekonomik, rrjedhimisht në rënien e nivelit të inflacionit;
- ✓ Prodhim i ulët në Kosovë dhe varësia e lartë nga importet;
- ✓ Zhvillimet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare;
- ✓ Marrëdhëniet tregtare midis SHBA-së dhe Kinës.

Pritjet e bankave lidhur me dinamikën e inflacionit kanë qenë mjaft të sakta për vitin 2019 dhe për tremujorin e parë të vitit 2020, ndërkohë që për tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2020 si dhe për vitin 2020 në përgjithësi, pritjet e bankave për nivelin e inflacionit konsiderojmë se janë paksa të larta. Sidoqoftë, pritjet e bankave për vitin 2020 janë në përputhje me parashikimet e BQK-së sa i përket trendit, të cilat sugjerojnë nivel më të ulët të inflacionit krahasuar me vitin paraprak.

Grafik 8. Probabiliteti i inflacionit për TM3 2020 (boshti-x: pritjet e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje; boshti-y: probabiliteti)



Burimi: Bankat komercial dhe kalkulimet e BQK-së.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org